



# Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

## Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63  
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: sekretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

### NJOFTIM PËR POZICIONIN

#### “Shef/e Finance”

*Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpik Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.*

Në kuadër të Projektit “**Ekipe Sportive 2022**”, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës “**Shef/e Finance**”

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpike. Projekti do të formojë Ekipe sportive jashtë shkollore në nivelin 9-vjecar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollë e mesme (nga klasa 10 – 12); në universitete.

#### **Detyrat e Shefit/es të Financës**

Shefi/ja i/e financës do të kontrollojë, monitorojë ecurinë e shpenzimeve sipas zërave në projekt, duke bërë vlerësimet e tyre sipas periudhave të raportimit. Për të përmbushur objektivat e caktuara Shefi/ja e/i Financës duhet të kryejë detyrat si më poshtë:

- Meaxhon aspektin financiar të projektit dhe kryen gjithë veprimet e nevojshme për të përmbushur detyrimet sipas legjislacionit shqiptar;
- Mbajtja e të dhënave të sakta mbi transaksionet e kryera gjatë projektit;
- Proceson fatura, kontrollon faturat e blerjeve, rregjistron depozitat dhe pagesat bankare. regjistron faturat e blerjeve, arka, banka etj;



## Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

### Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63  
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: sekretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

- Regjistron llogaritë e arkëtueshme dhe pagueshme;
- Përditëson sistemet e brendshme me të dhënat financiare;
- Ndjek dhe rakordon buxhetet e cdo zëri projekti;
- Monitoron arkivimin e dokumentacionit fizik mujor;
- Delegon detyra tek specialisti/ët i finances dhe monitoron punën e tij/saj;
- Mban marrëdhënie me Thesarin e Shtetit, Ministrinë e Financave etj;
- Raporton tek drejtori i projektit dhe punon ngushtësisht me specialistin e prokurimeve;
- Mban orët e punës dhe ditët e pushimit të gjithë burimeve njerëzore të angazhuara në projekt;
- Cdo detyrë tjetër që i përshtatet pozicionit të punës.

#### **Kualifikimet dhe Eksperienca:**

- Diplomuar në Fakultetin Ekonomik, Dega Financë- Kontabilitet;
- Të ketë 3-5 vite eksperiencë profesionale, prioritet do kene individët me eksperiencë të mëparshme më fonde të Buxhetit të Shtetit;
- Njohuri të mira të paketës MS Office (Excel është i domosdoshëm);

#### **Aftësi dhe kompetenca kryesore**

- Të ketë aftësi të mira komunikuese;
- Të ketë aftësi të mira analitike, saktësi në kryerjen e detyrave;
- Njohuri mbi programet e ndryshme financiare;
- Njohuri të mira mbi procedurat e Thesarit të Shtetit si dhe procedurat e Prokurimeve Publike;



## Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

### Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63  
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: [secretariat@nocalbania.org.al](mailto:secretariat@nocalbania.org.al) • <http://www.nocalbania.org.al>

- I/E aftë të punojë në mënyrë të pavarur;
- Etikë pune dhe përpikmëri.

#### **Procedura e aplikimit**

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë 12 Maj 2022, ora 16.00, në adresën [secretary.general@nocalbania.org.al](mailto:secretary.general@nocalbania.org.al) , me subjekt: **Aplikim për pozicionin Shef/e Finance "Ekipet Sportive 2022"**.

